



Data 05.07.2024

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

“Riaftësim strukturor i Pallatit nr.8 dhe nr.10, Rruga "Pelikan", Kod GIS 5709-5711.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi CPV: 45000000-7- Punë ndërtimi**

**Në mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar;**

**Për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte “Procedurë e përshpejtuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:**

*Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumenta.*

*Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.*

- 1. VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL: 291.310.068** (dyqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë

Afati i realizimit të punimeve është :224 ditë.

Garancia për mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

**Argumentim:**

**MBI PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS SË PROKURIMIT ME TITULL:  
OBJEKTI :**

“Riaftësim strukturor i Pallatit nr.8 dhe nr.10, Rruga "Pelikan", Kod GIS 5709-5711.

Në zbatim të urdhërit të grupit te Specifikimeve nr. 202 datë 26.06.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit per objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

Dokumentave sipas Buxhetit te Bashkise për fondit limit, shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, te hartuar nga projektuesi BOE “**ARKONSTUDIO shpk**”, “**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000 shpk**”,“**ERALD –G shpk**” ne baze te Kontrates me Bashkine Durres me nr. 661 prot. Dt.18.01.2021.

**PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet tenike të hartuara nga projektuesit:ing.Dhimitër Papa dhe te miratuara ne institutin e ndertimit, objekt i ketij prokurimi.

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plo të me kërkesat e Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 36.*

**PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS**

**Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimete botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga

autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

**Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:** Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga Projektuesit, BOE “**ARKONSTUDIO shpk**”, “**A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000 shpk**”, “**ERALD –G shpk**”, dhe të miratuara nga Instituti i Ndërtimit për projekt zbatimin e objektit:

“Riaftësim strukturor i Pallatit nr.8 dhe nr.10, Rruga "Pelikan", Kod GIS 5709-5711”  
Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull:

“Riaftësim strukturor i Pallatit nr.8 dhe nr.10, Rruga "Pelikan", Kod GIS 5709-5711” rezultoi të jetë:

**Me vlerë:** 291 310 068lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"si dhe nenit

---

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 290'000'000 lekë

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",neni 43,b*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023,të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar.Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 110’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 440’000’000 lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

*Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 12.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo me shume se 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

---

*Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

- **Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:**

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:
- b. NP-2 D – Ndertime civile dhe industriale
- c. NS-1 A– Punime per prishjen e ndertimeve,

- d. NS-2 A– Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- e. NS-4 C– Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- f. NS-14 A– Impiante te brendshem, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

**Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve,**

Kategoria e kërkuar	Pershkrim i i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2 D	Ndertime civile dhe industriale	An-1 Perforcim kolone betonarme An-3 Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 ( Përfshire punimet te forimit te kollonave dhe trareve ekzistues dhe mbushje e brimave ) 3.761/2 Torkretim me llac cemento 1:2, t=5cm 2.117/1b Kollona b/a monolite lidhese 20x20 cm C 25/30 h ~ 4m An - 4 Brez b/a monolit 20x15cm C 25/30, h ~ 8 m An-12 F V hekur betoni ne b/arme Ø 3 ~ 5mm (mure fi5) 2,166 F V hekur betoni periodik Ø 6- 10 mm 2,167 F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm 2.122/1a Soleta te plota b/a C 20/25 ( soleta dhe shkalle ) 2,166 F V hekur betoni periodik Ø	101-200 mln leke	149.533.862 leke

		6- 10 mm 2,167 F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm 2,84 Mur me tulle me 8 vrima, t=10cm, h~3m, llaç perzier M15 m <sup>3</sup> 2,84 Mur me tulle me 8 vrima, t=20cm, h~3m, llaç perzier M15 m <sup>3</sup>		
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	2.426/3 Prishje shtresa betoni 2.426/4 Prishje soleta b/a, shkalle b/a 2,426 Prishje mur tulle pa pastrim An-5 Prishje suva ekzistuese muri An-6 Prishje suva ekzistuese tavani An-7 Prishje suva ekzistuese fasade 2.37/5b Transport materiale ndertimi deri ne 10km	0-20 mln leke	<b>7.533.262</b> Leke
NS-2 A	Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre	2.491/a F.V. Tub e rakorderi ujesjellesi PPR d=20mm, PN 16 2.491/b F.V. Tub e rakorderi ujesjellesi PPR d=25mm, PN 16 2.491/c F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PP-R , Ø32 X 4.4 mm PN 16 F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.) 2.494/1 F.V. Saracineska bronzi 3/4" 2,501 F.V Pajisje hidrosanitare WC allafrenga importi 2,495 F.V Pajisje hidrosanitare Lavaman porcelani importi me mishelator 2,506 F.V Pajisje hidrosanitare bide me mishelator An 149 F.V Pajisje hidrosanitare pjate dushi me mishelator An-15 F.V Boiler elektrik 80 Lit An-10 F.V. Mini saracineska M/M 1/2 - 1/2 Shkarkimet ne planimetri te WC-ve An F.V Tubo shkarkimi PP	0-20 mln leke	<b>15.896.700</b> Leke



		<p>d110</p> <p>An F.V Tubo shkarkimi PP d50</p> <p>2,515 F.V Pilete dysHEMEJE d50</p> <p>An F.V Tapa pastrimi Ø 110 mm</p> <p>F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)</p> <p>Kolonat e shkarkimeve dhe ventilimeve</p> <p>An F.V Tubo shkarkimi PP d75</p> <p>An F.V Tubo shkarkimi PP d110 kollone shkarkimi</p> <p>An F.V Tubo shkarkimi PP d110 kollone ventilimi</p> <p>F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)</p>		
NS- 4 C	<p>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.</p>	<p>2,264 Shtrese lluster çimento 1:2 t = 50 mm</p> <p>2.196/c Hidroizolim ne nyje sanitare me dy shtresa mapej ose ekuivalente</p> <p>2.267/b Shtrese me pllaka gres importi ( ambiente + tualete)</p> <p>2.273/5 Shtrim dhe Veshje shkalleve te brendeshme me pllaka mermeri t = 3cm</p> <p>2.324/a Plintuse pllake grez , h = 10 cm</p> <p>2,334 Suva e zakonshme fasade mur tulle h mbi 8 m</p> <p>2.310/1 Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>2.300/1 Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me pompe</p> <p>2,326 Veshje me pllaka (nyje sanitare)</p> <p>An-12 Suva strukurore me rrjete teli</p> <p>An- 16 C montim - heqje dyer dritare</p> <p>An- 17 Montim - dyer te brendshme</p> <p>An- 18 Montim - dritare d/alumin</p> <p>An- 20 Montim - dyer te blinduara importi</p> <p>2.375/a Dritare d/alumini dyfish xham</p> <p>2.383/1 F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re</p>	51-100 mln leke	99.733.477 Leke

		<p>2.386/2 Dyer te blinduara importi</p> <p>2,404 Lyrje me boje hidroplastike (fasada .)</p> <p>2,404 Lyrje me boje hidroplastike ( muret brenda )</p> <p>2,404 Lyrje me boje hidroplastike ( tavanet )</p> <p>2,2 Shtrese lluster cemento 1:2, mm</p> <p>2,197 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama</p> <p>2,2 Shtrese lluster cemento 1:2, mm mbi hidroizolim</p>		
NS-14 A	Impiante te brendshem , elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV	<p>480/2 F.V tub plastmasi Ø 18 ~ 21 mm</p> <p>480/3 F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm</p> <p>2.481/1 F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm<sup>2</sup></p> <p>2.481/2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm<sup>2</sup></p> <p>2.481/3 F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm<sup>2</sup></p> <p>2.482/1 F.V percjelles PPV, Ø 2 x 1.5 mm<sup>2</sup></p> <p>2,483 F.V Çelesa e priza 10 A</p> <p>2,485 F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim</p> <p>2,487 F.V Kutiderivacioni plastike</p> <p>2.490/d F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)</p> <p>2.490/1 F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A</p> <p>2.490/1a F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A</p> <p>2.490/1b F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A</p> <p>2. a-101 Çeles automat termo-elektro magnetik 2P;20A;220V</p>	0-20 mln leke	18.612.768 leke

		2. a-120 Llampe sinjalizimi 220V;1.2w An Priza telefonie An F.V kabell telefoni 2x0.5mm2 An F. V Kabell televiziv 75 An Deviator CAD 12 An Priza televizori		
--	--	--	--	--

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të paraqese dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune.*

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier elektrik 1 (një)
- b. Inxhinier hidroteknik 1 (një)
- c. Teknik Ndërtimi 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/liçenca e inxhinierëve, deshmi profesionale e teknikut te ndertimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- Manovratorë 1 punonjës
- Drejtues mjeti per automjetet e kerkuara 2 punonjës
- hidraulik 2 punonjës
- elektrikist 2 punonjës
- hidroizolues 4 punonjës
- murator 8 punonjës
- bojaxhi 8 punonjës
- hekurkthyes 6 punonjës
- karpentiere 6 punonjës
- Punëtoore ndertimi te thjeshte 18 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve me qëllim realizimin saktë të strukturave prej betoni kryesisht kemishimeve të kolonave, vendosjes së hekurave si dhe elementeve beton arme. Ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit, cilësinë e materialeve konkretisht betonit dhe hekurit.
- **Inxhinieri elektrik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektrike.
- **Inxhinieri hidroteknik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve hidraulike.
- **Tekniku i Ndërtimit** është i nevojshëm për zbatimin e të gjitha punimeve ndërtimore në baze të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe ëjane përgjegjës për koordinimin e punës në kantieret e ndërtimit.
- **Drejtuesit e mjetit** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve transportuese si kamion dhe autobetoniere.
- **Manovratorët** janë të nevojshme për drejtimin e mjetit fadrromë.
- **Hekurthyesit dhe karpentierët** duhen për realizimin në vend të strukturave beton arme sipas projektit (këmishimi i kolonave dhe tokretim)
- **Hidraulikët** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve hidraulike vendosjen e tubave të ndryshëm sipas zërave të preventivit.
- **Elektricitet** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve elektrike instalime dhe vendosje pajisjesh në baze të zërave të preventivit.
- **Muratorët** janë të nevojshëm për ndërtimin e mureve të tullave të tipeve të ndryshëm si dhe suvatimet e jashtme dhe të brendshme sipas projektit dhe zërave të preventivit.
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për hidroizolim të sipërfaqeve të tarracave apo ,mureve në baze të pershkrimit në projekt dhe zërat e preventivit.
- **Bojaxhinjtë** janë të nevojshëm për realizimin e lysterjes me boje sipas zërit të preventivit në gjithë sipërfaqen e llogaritur në projekt.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare prej **minimalisht 61 persona**.

Numri prej 61 punonjës përfshin **18** punëtorë të thjeshtë + **43 persona** janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, murator, hekurthyes, karpentier bojaxhinj të

përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikiisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjesve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë si dhe kontratave të ngjashme, në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Lloji Makinerive</b>	<b>SASIA</b>
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton	3 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale të autorizuar mbi 7.5-18 ton	2 cope
Autobetoniere	2 copë
Skela	6000 m2
Fadrome	1 cope

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të paraqese: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj).*

### **Argumetimi:**

**Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh edhe kombinimet e mundshme të punëve në kantier si dhe bazuar në metodologjinë e përdorur në projekt.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të

prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr.629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"

### **2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata**

Certifikat: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

#### **Argumentimi:**

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Certifikat: ISO 18001/45001 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

#### **Argumentimi:**

Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

## 1. Emri dhe adresa e autoritetit pergjegjës

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi "Liria", Qyteti Durrës  
Tel/Fax 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Faqja e Internetit [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

2. **Lloji i procedurës se prokurimit:**Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)

3. **Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** *Riaftësim strukturor i Pallatit nr.8 dhe nr.10, Rruga "Pelikan", Kod GIS 5709-5711.*

4. **Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-12226-07-05-2024

2. **5. Fondi / vlera e përafërt e kontratës:**291.310.068 (dyqind e nëntëdhjetë e një milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë

6. **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 224 ditë

7. **Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **18.07.2024** Ora: **10:00**  
Vendi: Prokurim elektronik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

8- **Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **18.07.2024** Ora: **10:00**  
Vendi:Prokurim elektronik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Elio Jani**